



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1806/1 Prot.

Lezhë, më 13.02.2025

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 131, datë 13.02 2025

**“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN E SJELLJES
SË NËPUNËSVE CIVILË GJATË PROCESIT ZGJEDHOR”**

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (Kreu 2, neni 5 dhe neni 37, të ligjit në fjalë), ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Kodit Zgjedhor të RSH dhe Vendimit nr. 9/2020, të KQZ, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

KONSTATOJ :

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. 117 prot., datë 06.02.2025, protokolluar nga ana jonë me nr.1806 prot., datë 07.02.2025 “Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”, ka udhëzuar njësinë përgjegjëse për të ngritur grupin e monitorimit, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe vijueshmërinë normale të punës së trupës së nëpunësve civilë, të pa ndikuar nga procesi zgjedhor gjatë veprimtarisë së tyre.

Në këto rrethana, mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur,

URDHËROJ :

1. Ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:

- Znj. Jetmira Leka - Drejtor, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse - Kryetar
 - Znj. Albana Nikolli - Përgjegjës Sektori, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse - Anëtar
 - Znj. Sara Ndoci – Specialist Juriste, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, - Anëtar
 - Znj. Donika Kola (Pergjoni) – Specialist i Burimeve Njerëzore (Për Administratën), Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse - Anëtar
2. Koordinatorin e grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces dhe me Komisionerin për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil do të jetë Znj. Sara Ndoci, me detyrë Specialist Jurist, Sektori i Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
 3. Grupi i punës të hartojë deri në datën 15.02.2025 rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregullime specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën do ta paraqesë për miratim tek Kryetari i Bashkisë.
 4. Me këtë Urdhër dhe Rregulloren e Brendshme të grupit të punës të njihen të gjithë nëpunësit civilë dhe të informohet Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil brenda datës 20.02.2025, duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës.
 5. Me zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Grupi i punës dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.
 6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

